veglave bujqësore. Këtij burri i japin 1-2 "babunë" (6-12 okë) kollomboq në vit. Mullxhiu e ka me "ujem," 4o/o - 6o/o prej drithit që bluan. Edhe Prifti, për hyzmetin e fêsë që bën, merr 25 "kile" kollomboq në mot.

Në kohërat e para kur mungonte kontrolli i këtij vëndi. Mirditasit hope hope zbrisnin nga malet edhe, me pushkë në dorë, plaçkitnin Zadrimën e qetë. Ky vënt ka qënë viktimi i burrave t'urëtuar e të blogët të Mirditës. Fatmirësisht k'o gjë sot nuk ngjet, ndonëse kur vjen behari bëhet grabitja e nonjë lope, e nonjë berre a të nonjë dhie.

Mjeshtëria e xhandarit duhet se i pëlqen Mirditasit me qënë se kam parë një numur të math të kenë zgjedhur këtë degë. Bukuria është se ruajtësi i tanishmë i ligjit më parë munt të ketë qënë kundravjtësi i saj. Me gjith këtë, detyrën e tij e bën jo më mirë. S'është e vërtetë se munt të transformohen në vegla sado dobiprurëse?

Mirditasi nuk ka dëshiruar mërgimin. Largoheshe nga shtëpia e tij vetëm për nonjë luftë. Mirëpo sot e shëkon në Mat si sharxhi, si bulk, etj.; e shëkon të punojë në për rrugët, të bëhet mjeshtër, të vejë shërbëtor, të hapë mademe, etj., s' është ky një ndryshim radikal!

Ky vënt ka plot egërsira dhe këto i japin